



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-04

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 shkurt 2022

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

**Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e
Paraburgimit**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Xhek Smith

Mbrojtësit të Pjetër Shalës:
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave:
Sajmon Los

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit” ose “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹ në përputhje me nenin 33(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”) është ngarkuar me shqyrtimin e një apeli të parashtruar më 22 nëntor 2021 nga z. Pjetër Shala (përkatësisht “Apeli” dhe “Shala”),² kundër “Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës” (“Vendimi i Kundërshtuar”).³ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS-ja”) u përgjigj më 3 dhjetor 2021 (“Përgjigja”) se apeli duhet të rrëzohet.⁴ Shala u kundërpërgjigj më 14 dhjetor 2021 (“Kundërpërgjigja”).⁵

I. HISTORIKU

1. Më 16 mars 2021, Shala u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”)⁶ në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake⁷ dhe pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij.⁸

¹ F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 24 nëntor 2021 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 10 shkurt 2022).

² F00001, Apeli i Mbrojtjes kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës më 10 nëntor 2021, 22 nëntor 2021 (konfidencial) (“Apeli”).

³ F00105/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës, 10 nëntor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 10 nëntor 2021) (“Vendimi i Kundërshtuar”).

⁴ F00003, Përgjigja e Prokurorisë ndaj Apelimit prej Mbrojtjes kundër “Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës”, 3 dhjetor 2021 (konfidenciale) (“Përgjigja”), para 2, 38.

⁵ F00004, Kundërpërgjigja e Mbrojtjes kundër Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit kundër “Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës”, 14 dhjetor 2021 (konfidencial) (“Kundërpërgjigja”).

⁶ F00013, Njoftimi i arrestimit të Pjetër Shalës sipas rregullës 55(4), 16 mars 2021 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 29 prill 2021).

⁷ F00008/A01/RED, Version i redaktuar publik i fletarrestimit për z. Pjetër Shala, 15 prill 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 qershor 2020, riklasifikuar si konfidencial më 19 tetor 2021).

⁸ F00007/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës, 6 maj 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 qershor 2020); shih edhe F00010/A02, Aktakuza, 19 qershor 2020 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si konfidenciale më 29 prill 2021). Aktakuza e korrigjuar, konkretisht aktakuza operative, u dorëzua më 1 nëntor 2021 nga ZPS-ja në përputhje me Vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Mocionin që kundërshton formën e Aktakuzës. Shih F00098/A01, Aktakuza e Korrigjuar, 1 nëntor 2021 (konfidencial); shih edhe F00107/A01, Version i Redaktuar Publik i Aktakuzës së Korrigjuar, 16 nëntor

2. Më 15 prill 2021, Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“Objekti i Paraburgimit”) në Hagë, Holandë.⁹
3. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën e Shalës për lirim të përkohshëm.¹⁰
4. Më 20 gusht 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelin e Shalës kundër Vendimit të Parë mbi Paraburgimin.¹¹
5. Më 10 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rishikoi mbajtjen në paraburgim të Shalës dhe urdhëroi vazhdimin e mbajtjes së tij në paraburgim.¹²
6. Më 10 nëntor 2021, pasi mori parashtrimet e ZPS-së dhe Shalës,¹³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Kundërshtuar, duke urdhëruar vazhdimin e paraburgimit të Shalës bazuar në faktin se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se Shala ka kryer krimet brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara.¹⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që Shala të arratiset ose të pengojë ecurinë e procesit të Dhomave të Specializuara ose

2021. Shih edhe F00089, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Vendimin mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës, 18 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 18 tetor 2021), para. 118.

⁹ F00019/RED, Version i redaktuar Publik i ‘Njoftimit për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit’, protokollimi F00019 datë 15 prill 2021, 26 prill 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 15 prill 2021, riklasifikuar si konfidencial më 29 prill 2021), para. 2.

¹⁰ F00045/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të përkohshëm, 23 qershor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 15 qershor 2021) (“Vendimi i parë i paraburgimit”); F00039/RED, Version i redaktuar publik i Mocionit për lirimin e përkohshëm, 17 qershor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 27 maj 2021).

¹¹ F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi lirinë e përkohshme) (“Vendimi i parë i apelit”); F00001/RED, Version i Redaktuar Publik i Apelit të Mbrojtjes kundër “Vendimit mbi kërkesën e Pjetër Shalës për lirim të përkohshëm” 31 gusht 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 28 qershor 2021).

¹² F00075/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi rishikimin e paraburgimit të Pjetër Shalës, 10 shtator 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 10 shtator 2021) (“Vendimi i dytë i paraburgimit”).

¹³ F00093, Parashtrimet e prokurorisë për rishikimin e dytë të paraburgimit, 25 tetor 2021; F00099, Përgjigja e Mbrojtjes ndaj “Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e dytë të Paraburgimit”, 1 nëntor 2021 (“përgjigja e Shalës ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Paraburgimit”).

¹⁴ Vendimi i kundërshtuar, paras 17-20.

të kryejë krime të tjera kundër personave që perceptohen sikur janë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), përfshirë dëshmitarët e mundshëm.¹⁵

7. Më tej Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se kushtet që propozoi Shala për lirim të tij me kusht ("Kushtet e Propozuara") mund të zvogëlonin në mënyrë të mjaftueshme rrezikun e arratisjes, por që këto kushte, kushti i arrestit shtëpiak me kushte shoqëruese të propozuara si alternative nga Shala ("Kushtet Alternative") ose kushte shtesë të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, janë të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit të Dhomave të Specializuara ose kryerjen e krimeve të tjera.¹⁶ Së fundmi, ai gjykoi se paraburgimi i Shalës mbetet proporcional.¹⁷

8. Në apel, Shala shtjellon tetë pika apeli që konsistojnë në gabime të pretenduara, mosshqyrtim të faktorëve të rëndësishëm dhe abuzim të diskrecionit nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁸ Shala kërkon që Paneli i Gjykatës së Apelit të miratojë apelin dhe të urdhërojë lirim të tij të menjëhershëm ose vendosjen në arrest shtëpiak në banesën e tij në Belgjikë me kushtet e përshtatshme.¹⁹

II. STANDARDI I RISHIKIMIT

9. Gjykata e Apelit miraton standardin e rishikimi për apelet e ndërmjetme të vendosur në vendimin e saj të parë dhe të zbatuar më pas.²⁰

¹⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para 25, 28-29, 32-34.

¹⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para 37-40.

¹⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para 43-46.

¹⁸ Apeli, para 3, 14.

¹⁹ Apeli, para 46-47.

²⁰ KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, paras 4-14. Shih edhe Vendimin e Parë të Apelit, para. 5.

III. ÇËSHTJE PARAPRAKE

10. Paneli i Apelit vëren se Shala dhe ZPS-ja nuk kanë dorëzuar versionet e redaktuara të Apelit, Përgjigjes dhe Kundërpërgjigjes respektive.²¹ Duke patur parasysh se të gjitha parashtrimet e dorëzuara pranë Dhomave të Specializuara do të jenë publike, përveç rasteve kur ka arsye të jashtëzakonshme për të qenë konfidenciale, dhe se palët do të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve jo-publike që janë dorëzuar pranë Panelit,²² Paneli urdhëron palët që të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të sipërpërmendura brenda dhjetë ditësh që nga marrja e njoftimit të këtij vendimi.

IV. DISKUTIM

A. GABIMI I PRETENDUAR NË LIDHJE ME BARRËN E PROVËS DHE STANDARDIN E ZBATUESHËM PËR RISHIKIMIN E PARABURGIMIT (PIKA 1)

1. Parashtrimet e palëve

11. Shala argumenton se ndonëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake e pranoi standardin e saktë provues, sipas të cilit ZPS-ja ka barrën e provës dhe duhet të japë argumente të veçanta dhe prova konkrete për të provuar se vazhdimi i paraburgimit është i nevojshëm në momentin e kryerjes së rishikimit,²³ ai nuk e zbatoi këtë standard kur vlerësoi ekzistencën e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, dhe në fakt e përmbysi barrën e provës.²⁴ Sipas pikëpamjes së Shalës, mbështetja e Gjykatësit të

²¹ Paneli vëren se Shala tregoi në kundërpërgjigjen e tij se ai do të dorëzojë një version të redaktuar publik të Apelit dhe Kundërpërgjigjes në kohën e duhur; gjithsesi ende nuk e ka bërë një gjë të tillë.

²² Shih p.sh. Vendimi i parë i Apelit, para. 6. Shih edhe KSC-BC-2020-06, F0004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 1 tetor 2021, (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021) ("Vendimi i dytë i Apelit për *Veselin*"), para. 9 (inkurajimi i palëve për të dorëzuar versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të tyre sa më shpejt që të jetë e mundur, pa prituri për një urdhër për ta bërë një gjë të tillë).

²³ Apeli, para. 15, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para. 16.

²⁴ Apeli, para 15-16, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para 28-29, 32. Shih edhe kundërpërgjigjen, para. 8.

Procedurës Paraprake në konstatimet e tij të para, pa kryer një vlerësim të hollësishëm të parashtrimeve të Mbrojtjes dhe mosmarrja e një vendimi nëse provat e dhëna nga ZPS-ja dëshmonin se vazhdonin të ekzistonin rreziqet, ishte e gabuar.²⁵

12. Nga njëra anë, Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur hodhi poshtë argumentet e dhëna më parë “thjesht sepse ato janë trajtuar tashmë” dhe kur u mbështet në “interpretimin e papërshtatshëm” të jurisprudencës së Panelit të Gjykatës së Apelit.²⁶

13. Nga ana tjetër, Shala argumenton se duke zhvendosur barrën e provës tek Mbrojtja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i lejoi ZPS-së që t’i shmangej detyrimit për të provuar se vazhdonin të ekzistonin kushtet për mbajtjen në paraburgim.²⁷ Më tej Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në pranimin e argumentit vetëm të ri dhe gjithsesi “tërësisht spekulues” se duke i nxjerrë e materialet shtesë Mbrojtjes mund të rriteshin rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.²⁸

14. ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e përmbysi barrën e provës, dhe duke marrë parasysh parashtrimet e palëve dhe standardin e duhur ligjor ai konstatoi se ZPS-ja kishte provuar se vazhdonin të ekzistonin rreziqet, të cilat, duke marrë parasysh nxjerrjen shtesë të materialit provues, mundësisht ishin rritur.²⁹ ZPS-ja gjithashtu parashtron se Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk iu kërkua që të shqyrtonte parashtrimet që ishin ngritur më parë nga Shala dhe ishin trajtuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vendimet e mëparshme.³⁰ Në pikëpamjen e ZPS-së, konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi rreziqet mbështeten në

²⁵ Apeli, paras 16, 18, referuar Vendimit të Kundërshtuar, paras 25-26, 28-29, 33. Shih edhe kundërpërgjigjen, para. 8.

²⁶ Apeli, paras 17-20.

²⁷ Apeli, para 15-16, 21. Shih edhe kundërpërgjigjen, para. 8

²⁸ Apeli, para. 16. Shih edhe kundërpërgjigjen, para. 8

²⁹ Përgjigja, para. 16.

³⁰ Përgjigja, para. 16.

rreziqe konkrete, të bazuara, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GjEDNj”).³¹

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

15. Si fillim, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake identifikoi me të drejtë se ZPS-ja: (i) ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm dhe (ii) duhet të japë argumente konkrete bazuar në prova se në momentin e rishikimit, vazhdimi i paraburgimit mbetet i domosdoshëm.³² Ndonëse Shala pranon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton standardin e saktë ligjor, në thelb ai kundërshton konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, dhe jurisprudencën e Panelit të Apelit,³³ se Gjykatësi i Procedurës Paraprake “nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorët që tashmë janë vendosur në vendimin e parë mbi paraburgimin, dhe as të trajtojë parashtrime që thjesht përsërisin argumentet që janë shqyrtuar në vendimet e mëparshme”, por thjesht duhet të përcaktojë nëse ende ekzistojnë arsye për vazhdimin e paraburgimit.³⁴

16. Paneli gjykon se thjesht përmendja nga Shala i këtyre konstatimeve, pa dhënë shpjegime të mëtejshme nuk mjafton për të provuar se Gjykatësi i Procedurës

³¹ Përgjigja, paras 17-19.

³² Vendimi i Kundërshtuar, para. 16; Vendimi i parë i Apelit, paras 24, 41. Shih edhe KSC-BC-2020-06, F00005, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit Kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021, para. 19.

³³ KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021 (“Vendimi i Apelit të *Haradinajt*”), para. 55; KSC-BC-2020-06, F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, (versioni konfidencial u dorëzua më 30 prill 2021), para. 60; KSC-BC-2020-06, F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit të rishikimit të paraburgimit 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021), para 14, 17.

³⁴ Vendimi I kundërshtuar, paras 16, 24, 28. Shih edhe Vendimin e kundërshtuar, paras 32, 38-39. *Contra Appeal*, para. 20

Paraprake ka gabuar në qasjen e tij. Gjithsesi, Paneli i Gjykatës së Apelit rikujton gjetjet e tij në Vendimin e Apelit të *Haradinajt*:

Paneli kompetent ka detyrimin të rishikojë arsyet ose rrethanat që mbështesin paraburgimin dhe të përcaktojë nëse këto arsye vazhdojnë të ekzistojnë, sipas nenit 41(6) të Ligjit. Paneli kompetent nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorët që tashmë janë vendosur në vendimin e parë mbi paraburgimin, por duhet të shqyrtojë arsyet ose rrethanat në fjalë dhe të përcaktojë nëse ato ende ekzistojnë. Thelbësore është që paneli kompetent të bindet se në kohën e marrjes së vendimit mbi rishikimin e paraburgimit, arsyet për vazhdimin e paraburgimit vijojnë të ekzistojnë.³⁵

17. Në këtë aspekt, Paneli gjithashtu rikujton se nuk është i lehtë detyrimi për të përcaktuar nëse rrethanat që mbështesin paraburgimin “vazhdojnë të ekzistojnë”³⁶. Ai vendos mbi panelin kompetent detyrën që të vlerësojë *proprio motu* nëse është ende i bindur se paraburgimi i të akuzuarit mbetet i përligjur në kohën e marrjes së vendimit të rishikimit dhe duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të çështjes.

18. Paneli ka konstatuar, në vendime të mëparshme,³⁷ se ndonëse rishikimi automatik çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk kufizohet rreptësisht në faktin nëse ka ndodhur apo jo një ndryshim në rrethanat e çështjes, ky ndryshim gjithsesi mund të jetë vendimtar dhe do të merret parasysh nëse ngrihet para Panelit ose *proprio motu*.³⁸ Paneli i Apelit më tej konsideron se paneli mund t’u referohet konstatimeve të vendimeve të mëparshme nëse është i bindur se provat ose informacioni mbi të cilët mbështeten këto vendime vazhdojnë të mbështesin konstatimet e bëra në kohën e rishikimit.³⁹ Gjithashtu Paneli rikujton se nga Gjykatësi

³⁵ Vendimi i Apelit të *Haradinajt*, para. 55.

³⁶ Shih nenin 41(10) të ligjit: “nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim”.

³⁷ Shih p.sh. Vendimi i dytë i Apelit të *Veselit*, para. 15; KSC-BC-2020-06, F00008/RED Versioni i redktuar publik i Vendimit të Apelit të Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit (versioni konfidencial u dorëzua 27 tetor 2021) (“Vendimi i Dytë i Apelit të *Thaçit*”), para. 19.

³⁸ Rregulla 57(2) e Rregullores.

³⁹ Shih në mënyrë të ngjashme ICC, *Prosecutor v. Gbagbo and Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-992-Red, Judgment on the appeal of Mr Laurent Gbagbo against the decision of Trial Chamber I of 10 mars 2017 entitled “Decision on Mr Gbagbo’s Detention”, 19 korrik 2017, para. 39.

i Procedurës Paraprake nuk pritet që të shqyrtojë parashtrime që vetëm përsërisin argumentet që janë trajtuar tashmë në vendimet e tij të mëparshme.⁴⁰ Duke patur parasysh sa më sipër, Paneli është i bindur se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka zbatuar standardin e duhur⁴¹ në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së.⁴²

19. Për aq sa i takon pretendimit të Shalës se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar në vlerësimin e tij nëse rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit vazhdojnë të ekzistojnë, Paneli do t'i shqyrtojë këto pretendime drejtpërdrejt në pjesët përkatëse të diskutimit më poshtë.⁴³

20. Si rezultat, Gjykata e Apelit konstaton se Shala nuk ka provuar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në zbatimin e standardit të duhur gjatë rishikimit të vazhdimin të paraburgimit të Shalës. Për këtë arsye, pika e parë e apelit të Shalës hidhet poshtë.

B. GABIMET E PRETENDUARA NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E NENIT 41(6)(B) TË LIGJIT (PIKAT 2, 3, 4, 5 DHE 6)

1. Neni 41(6)(b)(i) i Ligjit (Pika 2)

21. Fillimisht, Paneli vëren se Shala paraqet argumente të cilat shtjellojnë vetëm rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit në pikën e dytë të Apelit.⁴⁴ Duke qenë se përfundimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se paraburgimi i Shalës duhet të

⁴⁰ Shih p.sh. Vendimi i dytë i Apelit të *Veselit*, para. 16; Vendimi i dytë i Apelit të *Thaçit*, para. 20.

⁴¹ Shih Vendimi a Kundërshtuar, para. 16. Shih gjithashtu Vendimi I Kundërshtuar, para 24-25, 28-29, 32-33. Apelim Contra, para. 18; shih edhe Apeli para. 20.

⁴² Shih p.sh. GJEDNJ, *Merabishvili v. Georgia*, no. 72508/13, Judgement, 28 November 2017, para. 222 (arsyetimi duhet të mbështetet në rrezik të vecantë të bazuar).

⁴³ Shih p.sh. Apeli, para. 16; Kundërpërgjigja, para. 8 (nxjerrja e provave). Paneli nuk do të shqyrtojë më tej argumentet e Shalës në lidhje me deklaratat e shkuara për dëshmitarët e mundshëm pasi ato janë trajtuar dhe hedhur poshtë në Vendimin e Parë të Apelit. Shih Kundërpërgjigjen, para 4-7; Shih edhe Vendimin e Parë të Apelit, para 34-38, 41-42.

⁴⁴ Shih Apeli, para 22-23. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 9.

vazhdojë nuk bazohet në konstatimet në lidhje me rrezikun e arratisjes,⁴⁵ Paneli e hedh poshtë menjëherë këtë pikë të apelit.⁴⁶

2. Neni 41(6)(b)(ii) i Ligjit (Pikat 3, 4, 5 dhe 6)

(a) Parashtrimet e Palëve

22. Së pari, Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se ekzistenca e masave mbrojtëse nuk ndikon në konstatimin se ekziston rreziku i pengimit të ecurisë së procesit.⁴⁷ Sipas Shalës, për shkak të masave mbrojtëse në fuqi, ai nuk ka dijeni për vendndodhjen aktuale ose të dhënat e kontaktit të dëshmitarëve të mbrojtur, [REDAKTUAR].⁴⁸ Shala më tej vëren se [REDAKTUAR] ka zvogëluar ndjeshëm çdo rrezik të perceptuar të pengimit në ecurinë e procesit.⁴⁹

23. Së dyti, Shala argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi gabimisht se ekzistenca e masave mbrojtëse dëshmonte për “një rrezik të shtuar të pengimit të ecurisë së procesit”.⁵⁰ Në pikëpamjen e Shalës, këtij “konstatimi të përgjithshëm” i mungon arsyetimi dhe ai nuk merr parasysh arsyet e veçanta për vendosjen e masave mbrojtëse, shtrirjen dhe rëndësinë e tyre ndaj rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit në çështjen në fjalë.⁵¹

24. Së treti, Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se njohja e tij në rritje me materialin që ZPS-ja synon të përdorë në gjykim shton rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera,⁵² duke patur parasysh se (i) as Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe as ZPS-ja nuk kanë identifikuar ndonjë material specifik të nxjerrë pas Vendimit të Dytë mbi

⁴⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 37.

⁴⁶ Shih edhe Vendimin e Parë të Apelit, para 28-29.

⁴⁷ Apeli, para 14, 24, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para. 29.

⁴⁸ Apeli, para. 24.

⁴⁹ Apeli, para. 24.

⁵⁰ Apeli, para 14, 25, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para. 29.

⁵¹ Apeli, para 24-27. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 12.

⁵² Apeli, para. 28, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para 29, 33.

Paraburgimin që mund të kishte ndikim mbi rreziqet;⁵³ (ii) nxjerrja e materialit shfajësues mund të zvogëlojë rreziqet;⁵⁴ dhe (iii) e drejta themelore e të akuzuarit për të patur qasje në provat kundër tij, nuk duhet të përdoret në dëm të tij gjatë vlerësimit të domosdoshmërisë së paraburgimit.⁵⁵

25. Së katërti, Shala argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se ZPS-ja nuk ka faktuar në mënyrë të mjaftueshme rreziqet e pengimit të ecurisë së procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera.⁵⁶ Në pikëpamjen e tij, parashtrimet e ZPS-së mbi këto rreziqe nuk janë më të arsyetuara se sa parashtrimet mbi rrezikun e arratisjes, të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake i konstatoi si të përgjithshme dhe të pa faktuara.⁵⁷

26. Në lidhje me masat mbrojtëse, ZPS-ja përgjigjet se Paneli i Gjykatës së Apelit ka shqyrtuar dhe rrëzuar argumentin e Shalës se një regjim më i gjerë masash mbrojtëse zvogëlojnë rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit.⁵⁸ ZPS-ja më tej argumenton se [REDAKTUAR], e shton rrezikun e pengimit [REDAKTUAR].⁵⁹

27. Për më tepër, ZPS-ja parashtron se konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se nevoja për masa mbrojtëse tregon një rrezik të shtuar të pengimit të ecurisë së procesit, në fakt mbështetet në rreziqet objektivist të justifikuara me të cilat përballen dëshmitarët e mbrojtur dhe fushëveprimin relativisht të kufizuar të kësaj çështjeje, çka e bën më të lehtë identifikimin e dëshmitarëve.⁶⁰

28. ZPS-ja argumenton se Shala nuk artikulon ndonjë gabim në përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se njohja në rritje e të akuzuarit me provat

⁵³ Apeli, para. 29. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 13.

⁵⁴ Apeli, para. 30. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 13.

⁵⁵ Apeli, para. 31.

⁵⁶ Apeli, para 32-33. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 14.

⁵⁷ Apeli, para. 32, referuar ndërmjet të tjerave Vendimit të Kundërshtuar, para. 37.

⁵⁸ Përgjigja, para 22-23, referuar Vendimit të Parë të Apelit, para. 41.

⁵⁹ Përgjigja, para. 24.

⁶⁰ Përgjigja, para. 25.

fajësuese e përkeqëson rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit.⁶¹ Në pikëpamjen e ZPS-së, ky konstatim mbështetet nga vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.⁶² ZPS-ja argumenton se Shala nuk diskuton mbi nxjerrjen që ndodhi mes vendimit të Dytë të Paraburgimit dhe Vendimit të Kundërshtuar të paketave të informacionit fajësues, por i referohet vetëm materialit shfajësues të nxjerrë vetëm pas Vendimit të Kundërshtuar.⁶³

29. ZPS-ja së fundmi parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gaboi në konstatimin se rreziku i pengimit të ecurisë së procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera janë faktuar mjaftueshëm, pasi Vendimi i Kundërshtuar mbështetet në fakte konkrete dhe të bazuara, përfshirë [REDAKTUAR].⁶⁴

30. Shala përgjigjet se parashtrimet e ZPS-së se [REDAKTUAR] shton rrezikun e pengimit [REDAKTUAR], është tërësisht spekuluese dhe e pa faktuar.⁶⁵

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

31. Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet në faktorët në vijim për të kryer vlerësimin e rrezikut të pengimit të ecurisë së proceseve të Dhomave të Specializuara sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit: (i) [REDAKTUAR]; dhe (ii) njohjen në rritje me provat ku mbështeten akuzat kundër tij, bazuar në nxjerrjen shtesë të materialit fajësues në vijim të Vendimit të dytë mbi Paraburgimin.⁶⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konstatoi se “domosdoshmëria për masa [mbrojtëse] dëshmon për një rrezik më të madh të pengimit të ecurisë së procesit duke qenë se akuzat bazë janë lehtësisht të dallueshme si rezultat i fushëveprimit relativisht të kufizuar të akuzave kundër z. Shala.”⁶⁷

⁶¹ Përgjigja, para 27, 29.

⁶² Përgjigja, para. 28, referuar Vendimit të parë të Apelit, para. 38.

⁶³ Përgjigja, para. 27.

⁶⁴ Përgjigja, para. 30, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para 29, 33.

⁶⁵ Kundërpërgjigja, para. 11.

⁶⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 29.

⁶⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 29.

32. Paneli i Apelit së pari i kthehet argumentit të Shalës në lidhje me ekzistencën e masave mbrojtëse.⁶⁸ Në lidhje me ndikimin e ekzistencës së masave mbrojtëse mbi rrezikun e pengimit [REDAKTUAR],⁶⁹ Paneli bie dakord me ZPS-në se Shala fillimisht përsërit në apel argumentet të cilat nuk ishin të suksesshme, jo vetëm para Gjykatësit të Procedurës Paraprake por më herët edhe para Panelit.⁷⁰ Në mënyrë të ngjashme, Paneli nuk gjen të gabuar as përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ekzistenca e masave mbrojtëse në çështjen në fjalë nuk ndikon mbi konstatimin se ekziston rreziku i pengimit të ecurisë së procesit,⁷¹ dhe as faktin që Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk dha arsyetim të veçantë në mbështetje të këtij përfundimi.

33. Shala argumenton për herë të parë në apel se vlerësimi i rrezikut nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake është cënuar nga [REDAKTUAR] – që në pikëpamjen e tij e zvogëlon në mënyrë domethënëse rrezikun e pengimit.⁷² Duket se ky informacion i është bërë me dije Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe Mbrojtjes vetëm me anë të parashtrimeve të ZPS-së me rastin e konferencës së katërt mbi ecurinë e çështjes, të dorëzuara më 9 nëntor 2021,⁷³ përkatësisht një ditë para përfundimit të afatit për nxjerrjen e vendimit mbi rishikimin e paraburgimit,⁷⁴ dhe nuk është konsideruar si një faktor në Vendimin e Kundërshtuar. Gjithsesi, në pikëpamjen e Panelit, [REDAKTUAR].⁷⁵ Rrjedhimisht, Paneli konstaton se nuk është e paarsyeshme

⁶⁸ Pika e tretë e Apelit të Shalës; shih Apeli, para. 24.

⁶⁹ Pika e tretë e Apelit të Shalës, para 24-27. Shih edhe kundërpërgjigjen, para 7, 11.

⁷⁰ Shih Vendimin e parë të Apelit, para 40-41, ku Paneli konstatoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte në dijeni të ekzistencës së masave mbrojtëse gjatë vendimmarrjes për rrezikun e pengimit dhe nuk gaboi në arritjen në këtë përfundim mbi ekzistencën e rrezikut duke patur parasysh rrethanat e çështjes, konkretisht duke patur parasysh [REDAKTUAR] referuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake, faktin që [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Shih edhe përgjigjen, para 2, 22-23.

⁷¹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 29.

⁷² Apeli, para. 24. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 11.

⁷³ F00102, Parashtrimet e prokurorisë për konferencën e katërt për ecurinë e çështjes, 9 nëntor 2021 (konfidenciale, para. 10. Është i disponueshëm edhe një version publik i redaktuar. Shih F00102/RED, Versioni i redaktuar publik i parashtrimeve të prokurorisë për konferencën e katërt për ecurinë e çështjes, 9 nëntor 2021, para. 10.

⁷⁴ Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores.

⁷⁵ Shih vendimin e parë të Apelit, para. 36, referuar vendimit të parë të paraburgimit, para. 33.

që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të dalë në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që Shala të pengojë ecurinë e procesit.⁷⁶

34. Gjithashtu, Paneli nuk gjen gabim në konstatimin e Gjykatësit të Procedurës paraprake se domosdoshmëria për masa mbrojtëse në çështjen aktuale dëshmon për një rrezik të shtuar të pengimit të ecurisë së procesit.⁷⁷ Në ndryshim nga pretendimi i Shalës,⁷⁸ ky nuk përbën një “konstatim të përgjithshëm” të zbatueshëm ndaj të gjitha çështjeve ku janë dhënë masat mbrojtëse. Përkundrazi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konsideruar veçoritë e çështjes në fjalë.⁷⁹ Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit nuk “shtohet” vetëm për shkak të ekzistencës së masave mbrojtëse. Niveli “i shtuar” i rrezikut mbështetet edhe në faktin se fushëveprimi i akuzave është i kufizuar, çka i bën ngjarjet ngjarjet mbi të cilat bazohen akuzat lehtësisht të dallueshme,⁸⁰ dhe për këtë arsye dëshmitarët dhe viktimat identifikohen më lehtë se sa në proceset e tjera, që përfshijnë akuza më të gjera.⁸¹ Më tej Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka të bëjë vetëm me [REDAKTUAR], por të gjithë dëshmitarët dhe viktimat në këtë çështje, [REDAKTUAR].⁸² Shala nuk arrin të vërtetojë një gabim në qasjen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose mungesën e arsyetimit të duhur.

⁷⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 29.

⁷⁷ Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 29.

⁷⁸ Pika e katërt e apelit të Shalës; shih Apelin, para 25-27.

⁷⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 29.

⁸⁰ Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 29. Në vendimin e dytë mbi Paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, specifikon se fushëveprimi relativisht i kufizuar i akuzave “i bën viktimat dhe dëshmitarët në çështjen gjyqësore aktuale më të identifikueshëm se sa në proceset e tjera, që përfshijnë akuza më të gjera”. Shih Vendimin e dytë mbi Paraburgimin, para. 31.

⁸¹ Shih Vendimin e Dytë mbi Paraburgimin, para. 31.

⁸² Shih p.sh. F00053/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Dytë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse, 12 korrik 2021 (konfidencial) (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 korrik 2021), para 16-18, 30(a); F00072/CONF/RED, Versioni konfidencial i redaktuar i Vendimit të Konsoliduar mbi Shtyrjen e Kërkesës për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesën për të Shtyrë Detyrimet për Nxjerrje Informacioni, 9 shtator 2021 (konfidencial) (version rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 9 shtator 2021), para 15, 22(a).

35. Duke iu kthyer argumenteve të Shalës mbi ndikimin e njohjes në rritje të të akuzuarit me provat fajësuese,⁸³ Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar se nxjerrja shtesë e materialit fajësues pas rishikimit të fundit të paraburgimit rrit rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit, duke pasur parasysh se Shala “ka përvetësuar një kuptim më të mirë të çështjes së ZPS-së, përfshirë dëshmitarët mbi të cilët ajo do të mbështetet gjatë gjykimit.”⁸⁴

36. Paneli rikujton se pavarësisht se nxjerrja e provave mund të jetë një faktor i rëndësishëm, ai është një faktor i vetëm që mund të merret parasysh kur vendoset nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm.⁸⁵ Gjithsesi nuk mjafton vetëm të thuhet se i akuzuari përbën rrezik për dëshmitarët ose do të pengojë ecurinë e procesit.⁸⁶ Paneli vëren se në Vendimin e Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e mori këtë faktor parasysh së bashku me faktorë të tjerë për të përcaktuar ekzistencën e rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit.⁸⁷

37. Lidhur me këtë, Paneli vëren se në periudhën ndërmjet nxjerrjes së Vendimit të Dytë të Paraburgimit më 10 Shtator 2021 dhe nxjerrjes së Vendimit të Kundërshtuar më 10 nëntor 2021, Mbrojtja u njoh me 109 prova materiali fajësues.⁸⁸ Në pikëpamjen e Panelit, fakti se Shala mund të jetë në dijeni të

⁸³ Pika e pestë e apelit të Shalës; shih Apeli, para 28-31.

⁸⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 29.

⁸⁵ Vendimi i dytë i Apelit të *Veselit*, para. 31, referuar ICC, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-278-Red, Public redacted version of Judgment on the appeal of Mr Laurent Koudou Gbagbo against the decision of Pre-Trial Chamber I of 13 July 2012 entitled “Decision on the ‘Requête de la Défense demandant la mise en liberté provisoire du président Gbagbo’”, 26 tetor 2012, para. 65.

⁸⁶ ICTY, *Prosecutor v. Stanišić*, IT-04-79-AR65.1, Decision on Prosecution’s Interlocutory Appeal of Mićo Stanišić’s Provisional Release, 17 October 2005, para. 28; ICTY, *Prosecutor v. Brđanin and Talić*, IT-99-36-PT, Decision on Motion by Radoslav Brđanin for Provisional Release, 25 korrik 2000, para. 19. Shih gjithashtu ICTY, *Prosecutor v. Brđanin and Talić*, IT-99-36-PT, Decision on Motion by Momir Talić for Provisional Release, 28 mars 2001, para. 34.

⁸⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 29.

⁸⁸ Ky numër merr parasysh një paketë të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(1)(a) të Rregullores dhe gjashtë paketa të nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, që përmbajnë 109 prova materiali fajësues që përbën më shumë se 2400 faqe. Kjo përfshin të gjithë materialet e këtyre paketave dhe për këtë arsye nuk llogaritet duplikimin e informacionit për shkak të përfshirjes së versioneve të përkthyer, redaktuara dhe ose të rishikuara të materialeve të caktuara brenda këtyre paketave të nxjerrjes së informacionit.

materialit shfajësues – argument i cili u ngrit për herë të parë në apel – është i parëndësishëm.⁸⁹ Ai nuk do të ndryshonte faktin se qasja e rritur në prova rrit *aftësinë* për të penguar procesin duke qenë se të akuzuarit i vihen në dispozicion më shumë prova.⁹⁰

38. Shala nuk arrin të provojë se ishte e paarsyeshme nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të mbështetëj në njohurinë e tij në rritje me provat që mbështesin akuzat kundër tij dhe të arrinte në përfundimin se duke patur parasysh [REDAKTUAR], kontribuon në rreziqet e identifikuara të nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit. Për këto arsye, përkundër pohimit të Shalës,⁹¹ vlerësimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk çënon prezumimin e pafajësisë dhe është në përputhje me të drejtat themelore procedurale të Shalës.

39. Për më tepër, Paneli konstaton se nuk mjafton fakti që Shala i referohet “parashtrimeve të pabazuara dhe të përgjithshme të ZPS-së”, pa dhënë shpjegime të mëtejshme për të treguar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar në vlerësimin e tij.⁹² Për këtë arsye Paneli e hedh poshtë menjëherë këtë pretendim të pashtjelluar. Gjithsesi, Paneli ka konstatuar tashmë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka zbatuar standardin e duhur në rishikimin e vazhdimin të mbajtjes në paraburgim të Shalës.⁹³

40. Rrjedhimisht, pika e tretë dhe e katërt e apelit të Shalës dhe pjesët përkatëse të pikës së pestë dhe të gjashtë të apelit hidhen poshtë.

⁸⁹ Shih apelin, para. 30, referuar nxjerrjes së materialit 24. Paneli vëren se në apelin etij, Shala I referohet në vecanti paketës sipas rregullës 103, e cila u nxor pas lëshimit të Vendimit të Kundërshtuar dhe e cila “përmban material të rëndësishëm shfajësues”.

⁹⁰ Vendimi i dytë i Apelit të *Thaçit*, para. 40.

⁹¹ Apeli, para. 31; Kundërpërgjigja, para. 12.

⁹² Pika e gjashtë e apelit të Shalës; shih Apelin, para 32-33.

⁹³ Shih më lart, para. 20.

3. Neni 41(6)(b)(iii) i Ligjit (Pikat 5 dhe 6)

41. Paneli vëren se në pikën e pestë dhe të gjashtë të apelit, Shala sjell argumente që trajtojnë në të njëjtën kohë rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit.⁹⁴ Duke qenë se Paneli nuk konstaton gabime në përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ekziston rreziku i pengimit të ecurisë së procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, gjë që e bën vazhdimin e paraburgimit të domosdoshëm, nuk është e nevojshme që të shqyrtojë pretendimet për gabimet e pretenduara lidhur me nenin 41(6)(b)(iii) të Ligjit.⁹⁵

42. Paneli do të shqyrtojë nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në gjetjen se rreziku i pengimit të ecurisë së çështjes dhe kryerjes së krimeve të tjera nuk mund të zvogëlohet nga Kushtet e Propozuara ose Alternative.

C. GABIMET E PRETENDUARA LIDHUR ME VLERËSIMIN E KUSHTEVE TË LIRIMIT (PIKAT 7 DHE 8)

1. Parashtrimet e Palëve

43. Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se Kushtet e Propozuara dhe Alternative, konkretisht arresti shtëpiak në Belgjikë me kushte shoqëruese, nuk janë të mjaftueshme për të zvogëluar rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, pa dhënë arsye të mjaftueshme ose pa vlerësuar në mënyrë të hollësishme kushtet.⁹⁶ Në veçanti, Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në konstatimet e tij mbi mundësinë e përdorimit të pajisjeve që u përkasin të tjerëve, injoroi kushtet e propozuara se çdo vizitori do t'i kërkohej të dorëzonte

⁹⁴ Apeli, para 28-33.

⁹⁵ Shih p.sh. Vendimi i parë i Apelit, para. 43.

⁹⁶ Apeli, para 34-35, 42, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para 38, 40. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 15.

pajisjet elektronike para hyrjes në banesën e Shalës dhe se do t'i nënshtrohej kontrollit dhe mbikëqyrjes së mëtejshme.⁹⁷

44. Shala më tej argumenton se konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se, asnjë kusht i mundshëm nuk do të zvogëlonte rrezikun e komunikimit të paligjshëm me anë të përdorimit të gjuhës së fshehtë ose të koduar, është “spekulues dhe i pabazuar”, dhe prezumon sjellje kriminale nga ana e të akuzuarit, familjes së tij dhe stafit të sigurisë.⁹⁸ Në pikëpamjen e Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se e vetmja mundësi për “mbikëqyrje efektive” është brenda “mjedisit të kontrolluar” të Objektivit të Paraburgimit, duke keqkuptuar në këtë mënyrë realitetin e Objektivit të Paraburgimit.⁹⁹ Sipas Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk arriti të shqyrtojë mundësinë e mbikëqyrjes, përfshirë në gjuhën amtare të Shalës, në rast lirimi të përkohshëm dhe arresti shtëpiak në Belgjikë.¹⁰⁰ Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se “mungesa e garancive të dhëna nga Belgjika” ishte një arsye për të “mos kërkuar informacion të mëtejshëm nga Belgjika”.¹⁰¹

45. Për më tepër, Shala parashton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur hodhi poshtë pa arsyetim kërkesën e tij për pranimin e dëshmive nga ekspertët mbi aftësinë e mbikëqyrjes së komunikimeve të Shalës nëse ai do të lirohej ose do të vendosej në arrest shtëpiak në Belgjikë.¹⁰²

46. Së fundmi, Shala arrin në përfundimin se, për shkak të gabimeve të identifikuar më lart,¹⁰³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi një standard shumë të lartë dhe të paarrtshëm për kushtet e propozuara të lirimit të cilat nuk mund të

⁹⁷ Apeli, para. 36.

⁹⁸ Apeli, para 37, 39.

⁹⁹ Apeli, para 37-38, 45.

¹⁰⁰ Apeli, para. 37.

¹⁰¹ Apeli, para. 37, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para. 38.

¹⁰² Apeli, para 40-41.

¹⁰³ Shih më lart, paras 43-45.

plotësohen nga asnjë kusht, duke e bërë “virtualisht të pamundur” për të akuzuarin “që të ushqente edhe shpresën më të vogël për lirin e përkohshëm”.¹⁰⁴

47. ZPS-ja përgjigjet se në ndryshim nga pretendimet e Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i mori parasysh kushtet e propozuara nga Shala, përfshirë propozimet e reja, që, ndër të tjera, do t’u kërkohej vizitorëve të dorëzonin pajisjet elektronike para hyrjes në banesën e Shalës, por konstatoi se ato do të ishin të pamjaftueshme për të zvogëluar disa rreziqe të caktuara.¹⁰⁵ Në pikëpamjen e ZPS-së, Kushtet e Propozuara dhe Alternative nuk trajtojnë rrezikun që Shala mund t’u komunikonte të tjerëve informacion konfidencial në banesën e tij me anë të një morie mjetesh.¹⁰⁶ ZPS-ja më tej pretendon se në ndryshim nga regjimi i zbatueshëm në Objektin e Paraburgimit, autoritetet belge nuk do të ishin në gjendje të njihnin informacionin konfidencial në këtë çështje, përfshirë përmendjen e dëshmitarëve të mbrojtur dhe vëren se Shala thjesht i hedh poshtë këto shqetësime të cilat ai i konsideron spekuluese.¹⁰⁷ Në lidhje me dëshminë e ekspertëve të kërkuar nga Shala, ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi me të drejtë se kjo provë ishte e panevojshme.¹⁰⁸

48. Së fundmi, ZPS-ja konsideron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake zbatoi standardin e duhur në vlerësimin e kushteve të propozuara të lirit, siç dëshmohet nga analiza specifike e çështjes dhe konstatoi se disa nga kushtet e propozuara janë të përshtatshme për të zvogëluar rrezikun e moderuar të arratisjes së Shalës, por është më e vështirë të vendosen kushte për të zvogëluar pengimin e ecurisë së procesit ose sjelljes së re kriminale.¹⁰⁹

¹⁰⁴ Pika e tetë e apelit të Shalës; shih Apelin para 14, 43-45.

¹⁰⁵ Përgjigja, para. 32.

¹⁰⁶ Përgjigja, para. 33.

¹⁰⁷ Përgjigja, para. 34.

¹⁰⁸ Përgjigja, para. 35.

¹⁰⁹ Përgjigja, para 36-37.

49. Shala përgjigjet se argumenti i ZPS-së se asnjë kusht i propozuar nuk mund të zvogëlojë rrezikun e pengimit të ecurisë së çështjes, konfirmon faktin se standardi për vlerësimin e kushteve të propozuara të lirimit është vendosur tepër lart.¹¹⁰

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

50. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se Kushtet e Propozuara nuk do të zvogëlonin rrezikun që Shala të përdorte pajisje që i përket një personi të tretë ose t'u kërkonte të tjerëve të përdornin pajisjet e tyre me qëllim pengimin e ecurisë së procesit ose kryerjes së krimeve të tjera, dhe as nuk do të garantonin mbikëqyrjen efektive të komunikimeve të Shalës.¹¹¹ Në lidhje me mundësinë e arrestit shtëpiak në Belgjikë, shteti i vendbanimit të Shalës, dhe kushteve shoqëruese, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se këto opsione nuk do të parandalonin bashkëbisedimet ndërmjet Shalës dhe vizitorëve të miratuar.¹¹² Në pikëpamjen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, çdo kusht tjetër, si vizitat e monitoruara nga autoritetet belge, nuk do të zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit ose sjelljeve të reja kriminale, dhe se komunikimet e Shalës mund të kufizohen dhe mbikqyren mjaftueshëm vetëm me anë të kornizës së monitorimit të komunikimeve që përdoret në Objektivin e Paraburgimit.¹¹³ Për më tepër, duke patur parasysh mungesën e garancive nga Belgjika dhe papërshtatshmërinë e kushteve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykoi se nuk ekziston baza për të kërkuar informacion të mëtejshëm nga Belgjika.¹¹⁴ Së fundmi, Gjykatësi i Procedurës paraprake gjykoi se nuk është e nevojshme paraqitja e dëshmimeve të ekspertëve mbi mbikëqyrjen e komunikimeve, siç është kërkuar nga Mbrojtja.¹¹⁵

¹¹⁰ Kundërpërgjigja, para 16-17.

¹¹¹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 38.

¹¹² Vendimi i Kundërshtuar, para. 38.

¹¹³ Vendimi i Kundërshtuar, paras 38, 40.

¹¹⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 39.

¹¹⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 39.

51. Paneli i Gjykatës së Apelit së pari do të trajtojë pretendimin e Shalës se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk arriti të kryejë një vlerësim të hollësishëm të kushteve të lirit.

52. Paneli vëren se Shala propozoi kushte të zgjeruara, në veçanti Kushtet Alternative, të cilat në teori mund të kufizojnë dhe mbikqyrin komunikimet e tij jashtë Objektivit të Paraburgimit.¹¹⁶ Për shembull, Shala propozoi që vizitorët të dorëzojnë pajisjet e tyre elektronike para hyrjes në banesën e tij, të kontrollohen ose të japin pëlqimin për mbikëqyrjen e mëtejshme, në mënyrë që të parandalohet përdorimi nga ana e tij i pajisjeve elektronike që u përkasin personave të tjerë. Paneli së pari vëren se në kundërshtim nga pretendimi i Shalës,¹¹⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i injoroi këto Kushte Alternative por i mori ato në konsideratë dhe gjykoi se ato nuk do të parandalonin bashkëbisedimet e pambikëqyrura ndërmjet Shalës dhe vizitorëve të miratuar.¹¹⁸ Paneli konsideron se konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se komunikimet e Shalës mund të kufizohen dhe mbikqyren në mënyrë të mjaftueshme me qëllim zvogëlimin e pengimit të ecurisë së çështjes në objektin e paraburgimit, nënkupton se Kushtet Alternative nuk mund t'i japin zgjidhje të mjaftueshme këtij rreziku.

53. Paneli gjithsesi konsideron se Shala ka të drejtë kur pretendon se edhe në paraburgim ai mund të ketë vizita të pambikëqyrura;¹¹⁹ dhe se edhe në Objektin e Paraburgimit mund të përcillen mesazhe dhe udhëzime të paligjshme. Gjithsesi këto komunikime të pambikëqyrura janë rreptësisht të kufizuara. Për shembull, të akuzuarve u lejohen "vizita private" të pambikëqyrura, por vetëm për disa anëtarë të caktuar të familjes së ngushtë dhe brenda periudhave të kufizuara kohore.¹²⁰ Paneli

¹¹⁶ Përgjigja e Shalës ndaj Parashtrimeve të ZPS-së mbi Rishikimin e Paraburgimit, para 37-38.

¹¹⁷ Apeli, para. 36.

¹¹⁸ Vendimi i Kundërshtuar, para. 38. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 36 (veçanërisht poshtëshënimin. 68).

¹¹⁹ Shih Apelin, para. 38.

¹²⁰ Shih Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit, Vizitat dhe Komunikimet, KSC-BD-09/Rev1/2020, 23 shtator 2020 ("Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe

rikujton se këto komunikime dhe vizita në paraburgim i nënshtrohen një niveli mbikëqyrjeje në mjedisin e kontrolluar të Objektivit të Paraburgimit, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm.¹²¹ Sidoqoftë Paneli konsideron se nuk dihet nëse mund të zbatohet një nivel i ngjashëm mbikëqyrjeje bisedash si brenda dhe jashtë Objektivit të Paraburgimit, në veçanti në kushtet e arrestit shtëpiak në Belgjikë.

54. Në këtë aspekt, Paneli konstaton se informacioni i mëtejshëm mbi regjimin e paraburgimit në Objektivin e Paraburgimit, konkretisht mbi kufizimet e zbatueshme ndaj vizitave dhe komunikimeve dhe regjimit të mbikëqyrjes së vizitave, do të kishte ndihmuar Gjykatësin e Procedurës Paraprake në marrjen e një vendimi të bazuar në informacion. Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkoi parashtrime nga Administratorja për këtë pikë, në një çështje tjetër para tij dhe konsideron se ky informacion do të ndihmonte Gjykatësin e Procedurës Paraprake në vlerësimin e zvogëlimit të rreziqeve të identifikuara në këtë çështje.¹²² Prandaj Paneli udhëzon

Komunikimet”), Neni 24. Sipas kësaj dispozite, “[një] i paraburgosur lejohet të shpenzojë kohë me bashkëshorten/bashkëshortin ose partneren/partnerin dhe/ose me fëmijët në vizitë private të paktën një herë në tre (3) muaj me kohëzgjatje deri në tri (3) orë. Vizitat private kryhen jashtë rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit.” Shih edhe p.sh. Vendimi i dytë i Apelit të *Veselit*, poshtëshënimi. 95; KSC-BC-2020-06, F00005, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021) (“Vendimi i dytë i Apelit të *Selimit*”), poshtëshënimi 125.

¹²¹ Shih veçanërisht Udhëzuesin e Punës për Vizita dhe Komunikime. Në objektin e paraburgimit, vizitat që u bëhen të paraburgosurve, kryhen brenda rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit dhe ata mund të urdhërojnë që të bëhet incizimi, dëgjimi, përmbledhja dhe transkriptimi i vizitave me disa vizitorë (neni 15 i Udhëzuesit të Punës). Në raste urgjence, për shembull, nëse perceptohet se një i paraburgosur po përdor gjuhë të koduar për të ndërhyrë në proces, regjimi i paraburgimit lejon Shefin e Paraburgimit ose oficerin e paraburgimit të marrin masa urgjente sigurie, në veçanti kufizime të vizitave dhe komunikimeve të të paraburgosurit. Shih Udhëzuesin e Punës për Vizita dhe Komunikime, Neni 8(1). Masa të ngjashme urgjente sigurie lejohen edhe gjatë vizitës dhe komunikimeve me Mbrojtësin. Shih Udhëzuesin e Punës për Vizita dhe Komunikime, KSC-BD-10/Rev1, 23 shtator 2020, neni 16. Shih edhe Udhëzuesin e Punës për Vizita dhe Komunikime, neni 8(3). Shih edhe p.sh. Vendimi i dytë i Apelit të *Veselit*, para. 47; Vendimi i dytë i Apelit të *Selimit*, para. 53.

¹²² Shih KSC-BC-2020-06, F00522, Urdhër drejtuar Administratores për Dorëzim të Informacionit mbi Regjimin e Paraburgimit, 13 tetor 2021 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 3 dhjetor 2021). Shih edhe KSC-BC-2020-07, F00393, Urdhër drejtuar Administratores për Dorëzim të Informacionit mbi Regjimin e Paraburgimit, 22 tetor 2021.

Gjykatësin e Procedurës Paraprake të kërkojë nga Administratorja parashtrime të mëtejshme mbi regjimin e paraburgimit në Objektivin e Paraburgimit.

55. Duke kaluar tek çështja e garancive, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se nuk kishte bazë për të kërkuar informacion të mëtejshëm nga Belgjika duke patur parasysh “mungesën e garancive të dhëna nga Belgjika” dhe pamjaftueshmërinë e Kushteve të Propozuara dhe Alternative.¹²³ Në çështjen konkrete, Paneli vëren se Shala kërkon të lirohet në Belgjikë nën disa kushte të zbatuara nga autoritetet belge, por nuk duket të ketë kërkuar pëlqimin e autoriteteve belge ose ndonjë informacion të mëtejshëm mbi aftësinë e Belgjikës për të zbatuar kushte të tilla. Shala gjithashtu nuk i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të këshillohej me Belgjikën në lidhje me kushtet e lirimit ose të merrte garanci, dhe vetëm përmend faktin se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e bëri një gjë të tillë në apel.¹²⁴

56. Sidoqoftë, Paneli e gjen të bazuar pretendimin e Shalës se arsyetimi i Gjykatësit, sipas të cilit “mungesa e garancive të dhëna nga Belgjika” ishte arsye për “të mos kërkuar informacion tjetër nga Belgjika” është *me të meta* dhe për pasojë i pamjaftueshëm.¹²⁵ Në fakt, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideroi se garancitë paraprake nga Belgjika ishin të nevojshme para se të kërkonte informacion të mëtejshëm, ai duhet të kishte ftuar Mbrojtjen që së pari të hulumtonte me autoritetet belge nëse ato do të jepnin pëlqimin për lirimin me kusht të Shalës në territorin e tyre dhe mund të zbatonin në mënyrë efektive kushtet, si vizitat mbikqyrëse. Paneli rikujton se kryerja e një konsultimi të tillë është brenda kompetencave diskrecionare të Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 39(13) të Ligjit në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me paraburgimin, në varësi të rrethanave të çështjes.¹²⁶ Paneli konsideron se ndonëse është detyrë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të

¹²³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 38.

¹²⁴ Shih apeli, para. 37.

¹²⁵ Shih apeli, para. 37.

¹²⁶ Vendimi i parë i Apeli para 59-60 dhe referencat që përmban.

shyqërtojë të gjitha kushtet alternative të arsyeshme,¹²⁷ kërkimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake do të udhëhiqet nga parashtrimet dhe propozimet e Palëve.

57. Duke patur parasysh rrethanat specifike të kësaj çështjeje, Paneli gjykon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake abuzoi me diskrecionin e tij kur arriti në përfundimin se asnjë prej Kushteve të Propozuara ose Alternative, ose ndonjë kusht shtesë nuk mund të zvogëlonte rreziqet e identifikuara, pa ftuar më parë Mbrojtjen që të hulumtonte mbi gatishmërinë dhe aftësinë e Belgjikës për të zbatuar këto kushte. Paneli konsideron se duke patur informacion më konkret, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kishte qënë në gjendje të vlerësonte mundësinë e zbatimit të kushteve të propozuara nga Shala. Paneli thekson se mungesa e garancive paraprake nga ana e një Shteti të Tretë nuk e pengon Panelin që të kërkojë informacion nga ky shtet nëse Mbrojtja, ose në mënyrë më të përgjithshme Palët nuk i kanë marrë këto garanci ose nëse informacioni i dhënë nga ai shtet nuk është i mjaftueshëm për t'i dhënë mundësi panelit që të marrë një vendim të bazuar në informacion, duke qënë se kur shqyrtohet liria me kusht bëhet fjalë për lirinë e individit.¹²⁸

58. Paneli do të shyrtojë argumentin e Shalës se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të kishte kërkuar dëshmi nga ekspertët për mbikëqyrjen e komunikimeve jashtë Objektivit të Paraburgimit dhe në veçanti në Belgjikë, përfshirë aftësitë për të mbikëqyrur komunikimet në gjuhën shqipe.¹²⁹ Paneli rikujton se është gjithashtu në diskrecionin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të vendosë nëse është e domosdoshme që të kërkojë dëshmi ekspertësh mbi mbikëqyrjen e komunikimeve, në varësi të rrethanave të çështjes.¹³⁰ Në këtë çështje, ndonëse sipas Panelit, duke patur

¹²⁷ Shih KSC-BC-2020-06, F00005, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (version konfidencial u dorëzua më 30 prill 2021), para 85-86, referuar në poshtëshënimin 141 to KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Aktvendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuar nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 26 maj 2020, para. 70.

¹²⁸ Shih p.sh. Vendimi i dytë i Apelit të *Veselit*, para 49-51.

¹²⁹ Apeli, para 40-41. Shih edhe Përgjigja e Shalës ndaj Parashtrimeve të ZPS-së për Rishikimin e Paraburgimit, para 7, 34.

¹³⁰ Vendimi i Parë i Apelit, para. 60.

informacion më konkret Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të ishte në gjendje të vlerësonte mundësinë e zbatimit të kushteve të propozuara nga Shala, Paneli konsideron se dhënia e dëshmisë së ekspertëve *në këtë fazë* do të ishte e parakohshme, para se Mbrojtja të kërkonte informacion dhe garanci nga Belgjika. Në fakt, Paneli është i mendimit se autoritetet belge, në veçanti autoritetet gjyqësore dhe policore, janë në pozicionin më të mirë për të dhënë informacion në lidhje me aftësitë e Belgjikës për të mbikëqyrur komunikimet në një situatë lirie me kusht, dhe në përgjithësi për aftësinë e saj për të zbatuar Kushtet e Propozuara dhe Alternative, ose çdo kusht tjetër që Gjykatësi i Procedurës Paraprake e identifikon si të nevojshëm për të zvogëluar rreziqet e identifikuara.¹³¹ Rrjedhimisht, në këtë fazë Paneli i hedh poshtë argumentet e Shalës në lidhje me dëshminë e mundshme të ekspertëve.

59. Së fundmi, duke patur parasysh se Paneli e miraton pjesërisht pikën e shtatë të apelit, nuk është e nevojshme të shqyrtohet me tej pika e apelit të Shalës se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte gabuar duke vendosur një standard tepër të lartë për kushtet e propozuara të lirimit¹³².

60. Duke patur parasysh sa më lart, Gjykata e Apelit miraton pjesërisht pikën e shtatë të Apelit të Shalës dhe e kthen çështjen tek Gjykatësi i Procedurës Paraprake në mënyrë që: (i) të kërkojë informacion nga Administratorja mbi regjimin e paraburgimit që zbatohet ndaj Shalës në Objektivin e Paraburgimit; (ii) të ftojë Mbrojtjen të konsultohet me autoritetet belge në lidhje me gatishmërinë dhe aftësinë e tyre për të zbatuar Kushtet e Propozuara, Kushtet alternative ose çdo kusht shtesë; dhe për pasojë (iii) të vlerësojë nëse këto kushte do të zvogëlonin rreziqet e identifikuara. Paneli vëren se kërkimi i informacionit në mënyrë që të marrë një vendim në bazë të informacionit, nuk e detyron në asnjë mënyrë panelin që të miratojë lirimin me kusht; përkundrazi, ai shërben si një bazë e shëndoshë që paneli të marrë një vendim bazuar

¹³¹ Shih përgjigjen e Shalës ndaj parashtrimeve të ZPS-së mbi Rishikimin e Paraburgimit, para 7, 34. Shih edhe Apelin, paras 40-41.

¹³² Apeli, para 43-46; Kundërpërgjigja, para 16-17.

në informacion të mjaftueshëm. Së fundmi, Gjykata e Apelit deklaron se pika e tetë e apelit të Shalës nuk ka objekt shqyrtimi.

V. VENDIM

61. Për këto arsye, paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON pjesërisht pikën e shtatë të apelit të Shalës;

IA KTHEN çështjen Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm në përputhje me paragrafët 54, 56 deri në 57, dhe 60 të këtij Vendimi;

HEDH POSHTË të gjitha aspektet e tjera të apelit (pikën e parë, të dytë, të tretë, të katërt, të pestë, të gjashtë dhe të tetë të apelit);

URDHËRON Shalën të dorëzojë versionet e redaktuara publike të apelit dhe Kundërpërgjigjes së tij brenda dhjetë ditësh që nga njoftimi i këtij vendimi; dhe

URDHËRON ZPS-në që të dorëzojë një version të redaktuar publik të Përgjigjes së saj brenda dhjetë ditësh që nga njoftimi i këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E premte, 11 shkurt 2022

Hagë, Holandë